



Datë: 27.03.2025
Numër Protokolli: 2276/2025

A.nr.218/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtar, me Atdhe Gashi në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.218/2025 të datës 27.01.2025, të parashtruar nga ankuesi G.K, kundër organit të punësimit Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me 27.03.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës A.nr.218/2025 të datës 27.01.2025, të parashtruar nga ankuesi G.K.

A r s y e t i m

Ankuesi, G.K (në tekstin e mëtejme referuar Ankuesi), kandidatë për pranim sipas procedurës së rekrutimit me numër reference RN00015652, të shpallur më datë 30.10.2024 nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, për pesë (5) pozitat e punës “*Inspektor Fitosanitar*”, më datë 27.01.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 540/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër zhvillimit të kësaj procedure të rekrutimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në mbështetje të dispozitave të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses tek Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ndërsa kjo e fundit, më datë 04.03.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit, pas pranimi të kërkesës së kryetares së Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjes së Ankesave, me Vendimin me numër VK/2025 dhe numër të protokollit 1621/2025 të datës 12.03.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës së parashtruar nga ankuesi edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, si dhe pretendimeve ankimore të ankueses, ka konstatuar se në këtë çështje juridike administrative janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, me datë 30.10.2024 ka bërë njoftimin publik për shpalljen e konkursit me numër reference RN00015652, gjegjësisht për pesë (5) për pozitën “*Inspektor Fitosanitar*”- **Grupi i Bujqësisë, Pyjeve dhe Tokës**, në kuadër të Drejtorisë së Inspektoratit, ku afati për aplikim ka qenë i hapur nga data 31.10.2024 deri me datë 29.11.2024.

Rrjedhimisht, sipas shkresave të lëndës rezulton se në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, mirëpo të njëjtit përmes Njoftimit të datës 12.12.2024 Sektori i Personelit i AUV-së. i ka refuzuar aplikacionin me arsyetimin se i njëjti nuk i ka plotësuar kriteret e konkursit, respektivisht kualifikimin përkatës të fushës së arsimit.

Tutje, sipas listës së verifikimit të kandidatëve, arrihet në konstatimin se tridhjetë e tetë (38) kandidatë e kanë kaluar fazën e verifikimit paraprak, ndërsa sipas Njoftimit të datës 30.12.2024 të renditjes përfundimtare të kandidatëve, konstatohet se kandidatë të suksesshëm rezulton të jenë gjashtë (6) kandidatë, respektivisht kandidati H.A me gjithsejtë 89.4 pikë, kandidati D.K me gjithsejtë 85.6 pikë, kandidati I.Sh me gjithsejtë 83.6 pikë, kandidati A.L me gjithsejtë 82.8 pikë, kandidati R.Xh me gjithsejtë 78.8 pikë dhe kandidati N.D me gjithsejtë 74.8 pikë.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e kundërshton njoftimin mbi refuzimin e aplikacionit të datës 12.12.2024, duke kërkuar nga Këshilli rishqyrtimin e aplikacionit të tij në mënyrë që të vazhdoj tutje më procedurat e rekrutimit.

Kolegji i Këshillit, ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankuesit të parashtruara si në ankesë dhe duke u bazuar në të dhënat e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rezulton se kandidati M.M, si kandidatë pjesëmarrës në procedurën e rekrutimit me numër reference RN00015652, më datë 29.01.2025 kishte parashtruar ankesë në Këshill, kundër procedurës së njëjtë, ndërsa, Këshilli me Vendimin me numër A.nr.238/2025, të datës 13.03.2025, ka anuluar Konkursin me numër reference RN00015652, për pesë (5) pozitat e punës *Inspektor Fitosanitar*, në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë.

Andaj, duke qenë se me Vendimin A.nr.238/2025, të datës 13.03.2025, është anuluar në tërësi Konkursi me numër reference RN00015625, Kolegji i Këshillit vlerëson se objekti i kësaj ankese është bërë i

pamundur apo i kotë dhe për rrjedhojë konstaton se në rrethanat e rastit konkret janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 104 ku përcaktohet se: ***“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”***.

Kështu që nën rrethanat e mësipërme dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi të përfundoj procedimin administrativ të filluar sipas ankesës me numër A.nr.218/2025, të datës 27.01.2025, siç përcaktohet në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.218/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit G.K;
- Udhëheqëses së Sektorit të Personelit në Agjencinë e Ushqimi dhe Veterinarisë; si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.